



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** dhe nenit 14, paragrafi **1** i Ligjit nr. 03/L - 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 7, paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.10/03 prill 2019), nenit 24, dhe nenit 25 të Rregullores QRK nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 52, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 02.06.2025, mori këtë:

V E N D I M
PËR VAZHDIMIN E DHËNIES NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME
TË KOMUNËS, KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

- I. MIRATOHET** Propozimi i Kryetarit të Kryeqytetit për vazhdimin e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, Këshillit Prokurorial të Kosovës.
- II.** Prona e paluajtshme e dhënë në shfrytëzim, e cekur në pikën I të këtij vendimi, është:
 1. Objekti i vendosur në parcelën kadastrale nr. P-71914059-06202-1, Zona kadastrale Prishtinë, në sipërfaqe bazë prej 280 m², në pronësi të Komunës së Prishtinës, i cili do të shërbej për nevojat e Këshillit prokurorial të Kosovës.
- III.** Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është siguri i hapësirës së nevojshme për funksionimin e këtyre institucioneve.
- IV.** Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është për 10 (dhjetë) vjet, duke e ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste specifike në pajtim me interesin publik.
- V.** Prona e paluajtshme e cekur në pikën II të këtij vendimi jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- VI.** Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të objektit do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet në mes të Kryetarit të Kryeqytetit dhe shfrytëzuesit.

- VII.** Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të komunës.
- VIII.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Kryeqytetit, Drejtoria e Pronës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Prishtinës.
- IX.** Pjesë përbërëse e këtij propozim-vendimi janë:
- kërkesa,
 - certifikata e pronës dhe
 - kopja e planit.
- X.** Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në ueb-faqen e komunës në gjuhët zyrtare.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-011/01-79064/25, më 4.6.2025

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina



A r s y e t i m

Këshilli Prokurorial i Kosovës në Prishtinë, i është drejtuar Komunës së Prishtinës me shkresën nr.14-360/01-47361/25, me anë të së cilës, ka kërkuar nga Drejtoria e Pronës, vazhdimin e shfrytëzimit të pronës komunale, objektin i cili është i vendosur në parcelën kadastrale me nr. 06202-1, Z.K. Prishtinë, sipërfaqe bazë prej 280 m², Komuna e Prishtinës.

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, sipas këtij propozimi është sigurimi i hapësirës së nevojshme për funksionimin e këtyre institucioneve.

Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është në afat prej dhjetë (10) viteve, duke e ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste specifike në pajtim me interesin publik, mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës, do të caktohen me kontratë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit.

Andaj duke u bazuar në dispozitat ligjore si në pjesën hyrëse të këtij Propozimi, dhe në shkresat e lëndës u vendos si në dispozitiv të këtij propozimi.